



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.289/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit, COMMANDO shpk me seli në Prizren, kundër debitorit Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave SHA në Prishtinë, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1320/22 datë 24.11.2023, me datë 15.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e debitorit Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave SHA në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhoma e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1320/22 i datës 24.11.2023, VERTETOHET

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkalles së Parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.1320/22 dt.24.11.2023, e ka Refuzuar ne tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave SHA në Prishtinë, i ushtruar kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.950/21 dt.24.03.2021, i Përmbartuesit Privat Rushit Haxha, dhe ka lënë ne fuqi Urdhrin përmbartimor P.nr.950/21 dt.24.03.2021.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet ankesa e debitorit, të prishet aktvendimi i atakuar dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallë te parë në rivendosje.

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës se Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori COMMANDO shpk me seli në Prizren, me datë 24.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave SHA në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës Nr.ARH/09-20 dates 01.10.2020 dhe faturës ARH/10-20 dt.02.11.2020. Përmbarruesi Privat Rushit Hoxha, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.950/21 dt.24.03.2021, ka lejuar përmbarrimin, me të cilin ka detyruar debitorin që kreditorit t'ia paguaj borxhin nga faturat në shumën prej 718.26 Euro me kamatë prej 8% nga data e faturimit të faturës së parë dt.01.10.2020 e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet për përpilimin e propozimit.

Debitori, ka parashtruar prapësim duke theksuar se kontrata në bazë të së cilës janë lëshuar faturat është ndërprerë nga debitori sipas vendimit dt.01.10.2020 dhe të njëjtit kanë kërkuar që pagesat për muajin shtator të mos ekzekutohen, i propozon gjykatës ta aprovoj prapësimin e debitorit ndërsa urdhrin përmbarrimor ta anuloj.

Përgjigje në prapësimin e debitorit ka paraqitur kreditori, me arsyetimin se debitori e pranon se nuk e ka kryer pagesën e faturës dhe thirret në një shkresë të AQP-së. Debitori nuk ka arrit të dëshmojë se nuk janë kryer shërbimet për muajin shtator e as të muajit tetor 2020, pra edhe pse shërbimet janë kryer në mënyrë të rregullt, debitori bën ndalesë të faturës, propozon që gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit, dhe të aprovet si i bazuar propozimi për përmbarrim.

Gjykata Komerciale –Dhoma e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, përgjigjes në prapësim dhe shkresave në lëndë ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1320/22 datë 24.11.2023, me të cilin e ka Refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbarrimor, duke vendosur kështu decidivishtë si në dispozitiv të njëjtit. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka gjetur se fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri përmbarrimor i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara dhe është i përshtatshëm për përmbarrim bazuar në dispozitat e nenit 29 dhe 37 të LPP-së. Faturat janë dorëzuar në origjinal nga kreditori dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, që vërtetohet nga vula e protokollit të debitorit 2014 dt.01.10.2020 nume rprotok.343 dt.02.22.2020, si dhe nga fakti që faturat nuk janë kontestuar asnjëherë nga debitori.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarrimore kur e ka refuzuar prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin të përmbarruesit privat, me të cilin është caktuar përmbarrimi i propozuar nga kreditori, ngase edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbarrimi është lejuar në bazë të faturave Nr.ARH/09-20 dates 01.10.2020 dhe faturës ARH/10-20 dt.02.11.2020, për shumën e përgjithshme të detyrimit prej 718.26€, të lëshuar nga kreditori e cila rezulton të jetë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, ashtu që të njëjtat fatura janë të vulosura dhe protokoluara me nr.04/2014 dt.11.10.2020

dhe 04/343 dt.12.11.2020 nga debitori. Këto fatura e kanë cilësinë e dokumentit të besueshëm konform nenit 29 paragrafi 1, pika 1.3 të LPP-së dhe si të tilla paraqesin bazë juridike për caktimin e përmbartimit, sepse i përmbajnë elementet siç kërkohet me paragrafin 3 të këtij neni, i cili shprehimisht përcakton se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shuma dhe koha e përmbartjes se detyrimit monetar”*, si dhe është në pajtim me nenin 37 të LPP-së, i cili përcakton se: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton qe propozimit ti bashkëngjitet dokumenti i tillë në origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Prandaj, bazuar në këto arsye, kjo gjykatë vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të bazuar në dispozita konkrete ligjore, ashtu që përfundimin juridik të dhomës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të LPK-së dhe me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së. Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë analizoi pretendimet e debitorit por vlerëson se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë konkrete në mbështetje të tyre siç parashihet me nenin 69 paragrafi 4 të LPP-së, ashtu që të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II nr.289/24 me datë 15.05.2024

Gjyqtari
Krenar Berisha